

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhjet vendore 2023

Rekomandime te tjera

Nr	Rekomandimi OSBE/ODIHR	Statusi implementimit	Komente dhe shënime të tjera
10	Aktet nënligjore që rregullojnë procesin zgjedhor duhet të miratohen në kohën e duhur për të garantuar siguri juridike, përgatitje efektive dhe njohjen e tyre nga publiku.	Progres i Munguar	Ky është një rekomandim i përsëritur që ju adresohet partive politike dhe Kuvendit, i cili si rregull nuk është zbatuar. Pavarësisht se pas zgjedhjeve lokale, 2023 Kuvendi ngriti menjëherë Komisionin për Reformën zgjedhore, ky Komision nuk realizoi asnjë produkt. Mundësitë për të bërë ndryshime në Kodin Zgjedhor për pasqyrimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR zvogëlohen përherë e më shumë sepse dita e zgjedhjeve po afron. Ndryshimet e bëra në Kodin zgjedhor në korrik, 2024 kanë trajtuar vetëm çështje të votimit nga jashtë territorit të vendit dhe votimin me votë parapëlqyese. Koha kur u bënë këto ndryshime i bënë ato realisht të zbatueshme duke plotësuar edhe kërkesat që lidhen me këtë rekomandim të OSBE/ODIHR.